



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Në bazë të Nenit 12, Paragrafi 12.2, Pika d; Nenit 40, Paragrafi 40.2, Pika c, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28, qershor 2008); Nenit 27 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048; Nenit 32, Paragrafi 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/1, i datës 11.09.2008, në seancën e Kuvendit të Komunës së Dragashit e mbajtur me dt. 08.04.2025, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miratohet ky:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PASHPENZUARA NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

Neni 1

Mjetet vetanake të buxhetuara për vitin 2024, të grumbulluta më tepër në raport me planin, kapin shumën prej **58,862.16 euro**. Mjetet e pashpenzuara nga Fondi 21 dhe 22 për vitin 2024 kapin shumën prej **28,377.08 euro**. Gjithsej shuma e grumbulluar më tepër në raport me planin, si dhe mjetet e pashpenzuara të Fondit 21 dhe 22 kapin shumën prej **87,239.24 euro**.

Neni 2

Mjetet vetanake të pashpenzuara nga **Neni 1** i këtij Vendimi, në shumën prej **87,239.24 euro**, barten në vitin 2025 dhe do të shpenzohen si në vijim të kësaj tablele:

Nr	O.B.	Programi	Përshkrimi i Projektit	Kategoria	Fondi	Shuma
		Buxhetor/Nënprgami		Buxhetore		
1	621	Administrata 163/16309	Mallra dhe Shërbime	13	22	92.72
2	621	Zyra e Kryetarit 160/16009	Subvencione	20	22	1,968.53
3	621	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 660/66350	Asfaltimi i rrugës Bresanë-Erëza-Kroi i Zgatarit-Guri i Vesës në fshatin Bresanë Projekti i ri	30	22	25,000.00

4	621	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 660/66350	Rregullimi i ujëmbledhësve dhe renovimi i kaptazhave të ujit në vendin "Gjybra e Pashës", "Brezhda" në fshatin Blaç Projekti- 54807	30	22	8,087.50
5	621	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 660/66350	Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Rrenc Projekti- 54873	30	22	12,500.00
6	621	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 660/66350	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Rugën "Prekoreka" në fshatin Krushevë Projekti- 54860	30	22	3,223.25
7	621	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 660/66350	Ndërtimi i ujësjellësit në vendin "Kukuljane" në fshatin Kukajan Projekti-52429	30	22	8,396.08
8	621	Administrata 920/92045	Subvencione	30	22	690.00
9	621	Arsimi fillor 920/93240	Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi dhe demolimi i Shkollës së vjetër "28 Nëntori" në fshatin Bresanë Projekti-55831	30	22	12,088.44
10	621	Shërbimet e Shëndetësisë Primare 730/73550	Renovimi i objektit të QKMF-së në Dragash Projekti-52352	30	22	14,173.40
11	621	Shërbimet e Shëndetësisë Primare 730/73550	Mallra dhe Shërbime	13	22	1,019.32
			Totali			87,239.24

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Dragashit, dhe do të implementohet përmes Ministrisë së Financave - Departamenti i Buxhetit.

A r s y e t i m

Në bazë të Nenit 9, Paragrafi 7 i Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, theksohet se të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2024 barten në vitin 2025, në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal, vetëm se për këtë duhet të ofrohen sqarimet apo arsyeshmëria e nevojshme në tekstin e vendimit të Kuvendit Komunal. Shpërndarja e mjeteve gjatë bartjes është si në tabelen e Vendimit për Bartjen e Mjeteve Vetanake në vitin 2025.

Mjetet për mallra dhe shërbime nga Administrata dhe Shërbimet e Shëndetësisë Primare kanë mbetur siç kanë qenë në vitin paraprak: në Administratë shuma prej 92.72€, ndërsa në Shërbimet e Shëndetësisë Primare shuma prej 1,019.32€.


Sa u përket mjeteve për subvencione nga Zyra e Kryetarit dhe në Administratë, kemi pasur mbetje të mjeteve në të dy këto pozicione dhe i kemi lënë njëjtë: në Zyrën e Kryetarit shumën prej 1,968.53€ dhe në Administratë shumën prej 690€.

Projekti-52352 për renovimin e objektit të QKMF-së në Dragash ka qenë në vitin paraprak dhe nuk i është ndryshuar struktura, pasi që do të vazhdojë realizimi i këtij projekti sipas Kontratës. Shuma e bartur për këtë projekt është 14,173.40€.

Sa i përket ndërtimit të këndit të lojërave, kubëzimit dhe demolimit të Shkollës së vjetër “28 Nëntori” në fshatin Bresanë (Projekti-55831), ky projekt ekziston në planifikimin buxhetor për vitin 2025, por duhet t’i shtohet edhe kjo shumë për ta realizuar në tërësi projektin. Shuma prej 45€ ka qenë tek Programi buxhetor për arsimin fillor, e mbetur nga projekti i cili ka përfunduar vitin e kaluar, ndërsa shuma prej 12,043.44€ është nga grumbullimi më tepër i të hyrave.

Tek rregullimi i ujëmbledhësve dhe renovimi i kaptazhave të ujit në vendin “Gjybra e Pashës”, “Brezhda” në fshatin Blaç (Projekti- 54807) - sipas kontratës, ky projekt në këtë vit duhet që të paguhet 28,087.50€. Meqenëse në buxhetin e vitit 2025 kemi të planifikuara vetëm 20,000.00€, atëherë duhet që t’i shtojmë shumën prej 8,087.50€ nga grumbullimi më tepër i të hyrave, në mënyrë që t’i përmbushim obligimet për këtë projekt sipas kontratës.

Sa i përket asfaltimit të rrugës Bresanë-Erëza-Kroi i Zgatarit-Guri i Vesës në fshatin Bresanë - projekti i ri – pasi që ky projekt vitin e kaluar ka qenë i paraparë në kuadër të Ministrisë, por nuk ka përfunduar (për të përfunduar duhen edhe 25,000.00€), atëherë ne si Komunë këtë obligim duhet ta paraqesim si projekt të ri. Këto mjete të bartura për këtë projekt janë nga grumbullimi më tepër i të hyrave.



Ndërtimi i ndriçimit publik në qendër të fshatit Rrenc, Projekti- 54873 - sipas kontratës, ky projekt është obligim i vitit 2025, por nuk është në Buxhetin e vitit 2025. Prandaj është paraparë bartje e mjeteve nga viti paraprak për realizimin e këtij projekti të ndriçimit publik në fshatin Rrenc. Shuma prej 9,652€, sipas kontratës, duhet që të paguhet këtë vit, mirëpo nevojiten edhe disa punime shtesë në shumë prej 2,848€ për ta përfunduar të gjithë projektin. Kjo shumë prej 12,500€ është paraparë nga grumbullimi më tepër i të hyrave.

Sa i përket ndërtimit të infrastrukturës rrugore në Rrugën "Prekoreka" në fshatin Krushevë, projekti- 54860 (shuma prej 3,223.25€); dhe ndërtimit të ujësjellësit në vendin "Kukuljane" në fshatin Kukajan, projekti-52429 (shuma prej 8,396.08€), këto dy projekte nuk kanë mundur të realizohen në vitin 2024, për shkak se janë marr mjetet nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, të shkaktuar nga kontrata kolektive e Arsimit dhe Shëndetësisë. Prandaj, obligimet e papaguara nga vitit i kaluar për këto dy projekte janë paraparë që të paguhen këtë vit, përmes bartjes së këtyre mjeteve. Shuma totale e të dy projekteve është 11,619.33€, ku nga mbetja e mjeteve nga projektet e realizuara të vitit të kaluar janë shtuar 10,433.44€, ndërsa pjesa tjetër prej 1,185.89€ janë shtuar nga grumbullimi më tepër i të hyrave vetanke.

01Nr. 060/01-5357-1/25

Dt. 08.04.2025

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj



A. Skeraj